

Legjionaret/ Vajushi e Gjasula shenojne tre gola per Liteksin

nga AlbaniaSoccer

E martë, 19 Nentor 2013 15:50



Nuk kane ndermend te ndalen ne Bullgari. Armando Vajushi dhe Jurgen Gjasula po i bejne te gjithë te cmenden me paraqitjet e tyre. Sulmuesi shkodran ka shenuar nje gol spektakolar nga 30 metra ne ndeshjen qe Liteksi ka fituar ne Kupa e Bullgarise me rezultatin 6-0 perballe skuadres Sozopol. Shqiptari tjetër Jurgen Gjasula ka shenuar nje dopiete ne kete goleade dhe ka marre vleresime maksimale nga trajneri. Te dy shqiptaret qe luajne per Liteksin po luajne dhe shenojne rregullisht ne Bullgari dhe kjo ka bere shume klube europiane te jene te gatshme per te paguar shume per ta.